REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DECAN
OPSTINA DECANI

DEÇANI

Në bazë të kërkesës së Komunitetit të fshatit Lloqan Komuna Deçan, të dt.19.03.2018, nr.02-8015, për caktimin e lokacionit për ndërtimin e "Memorialit të përbashkët të Dëshmorëve", duke u bazuar në nenin 14 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 dhe nenit 21 dhe 25 pika 7 të Statutit të Komunës së Deçanit, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e vet të mbajtur me dt.30.03.2018, bie këtë:

# VENDIM

## PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR NDËRTIMIN E MEMORIALIT TË PËRBASHKËT TË DËSHMORËVE NË FSHATIN LLOQAN

I.

Caktohet lokacioni për ndërtimin e "Memorialit të përbashkët të Dëshmorëve", në fshatin Lloqan, në parcelën nr.0498-0, Çertifikata P-70505078-00498-0, e evidentuar si P.SH.Shtëpia e Kulturës, Vendbanimi Hulaj-Lloqan.

II.

Implementimin e këtij Vendimi do ta bënë Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër e Komunës së Deçanit.

IV.

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale , si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

Me Vendim njoftohen: Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër dhe Arhivi i Komunës së Deçanit.

01.Nr.III-5
Deçan,dt.30.03.2018

KUVENDI I KOMUNËS SË DEÇANIT

Kryesuesi i Kuvendit
Haki Shehaj

REPUBLIKA E KOSOVA • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E DEÇANIT • OPSTINA DECANE • Skupstina Opstine • KUVENDI • ASSEMBLY OF MUNICIPALITY

HYRËSE-ULAZNA-INCOMING
REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E DEÇANIT • OPŠTINA DEČANE • DEÇANI MUNICIPALITY

Nga: / Od: / From: K Komunes
Nr. Prot: / Br. Prot: / Prot. No: 10293
Data: / Datum: / Date: 06.04.18
Nr. i faqeve: / Br. Stranica: / No Pages: 01
DEÇAN DEČANE